



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**DREJTORIA E INSPEKSIONIT**  
**DREJTORIA E BUQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM**  
**DREJTOIA E PRONËS, KADASTRIT DHE GJEODEZISË**

**N J O F T I M**

Njoftohen të gjithë shitësit e druve se ndalohet ekspozimi dhe shitja e masës drusore dhe produkteve të ndryshme nga druri (si: trarë, dërrasa, listela, etj.) në trotuare e hapësira të tjera publike në qytet dhe në tregjet jo legale.

Shitësit e druve dhe produkteve të ndryshme nga druri, të përmendura më lart, duhet t'i lirojnë trotuaret dhe hapësirat publike dhe të shfrytëzojnë Tregun e Druve që gjendet afër Tregut të kafshëve në Podujevë, më së largu deri më **04.07.2018**. Ndaj atyre që pas kësaj date do të hasen duke shitur produktet drusore jashtë Tregut të Druve do të ndërmerren masat përkatëse ligjore, konfiskimi i mallrave dhe inicimi i procedurave gjyqësore.

Në rast të mosveprimit sipas këtij njoftimi, Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtoria e Pronës Kadastrës dhe Gjeodezisë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës do të bëjnë lirim të hapësirave publike. Njëherësh, Komuna nuk do të mbajë përgjegjësi ligjore apo materiale në rast të konfiskimit të mallrave, gjësendeve dhe produkteve të tjera, të ekspozuara në hapësirat publike.

Nr. 11-334/07-0049883/18

Podujevë, 26.06. 2018

**DREJTORI**

Durim Salihu

Vezir Januzi

Faik Muçiqi

Abaz Llugaliu

